



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



**PROGRAMI ANGAZHIMI PËR BARAZI (E4E)**

**KËRKESË PËR APLIKIME (KPA)**

**RUNDI VII**

Marrëveshje bashkëpunimi Nr.: **AID-167-A-15-00001**

**Data e publikimit:** E premte, 28 shtator 2018

**Data dhe ora e mbylljes:** E mërkure, 31 tetor 2018, ora 16:00

**Vendi i dorëzimit:**

Kopje elektronike: [usaidatrcgrants@advocacy-center.org](mailto:usaidatrcgrants@advocacy-center.org)

Kopje fizike: Zyra e ATRC-së, Rr. Gazmend Zajmi nr 20, Prishtinë Kosovë

Të nderuar aplikues,

Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim -ATRC, partner implementues i Programit të USAID-it Angazhimi për Barazi - E4E, bën thirrje për parashtrimin e aplikacioneve nga organizatat e kualifikuara joqeveritare -OJQ-të kosovare që të:

- Zhvillojnë fushata komplekse të avokimit dhe vetëdijesimit në bashkëpunim me akterët nga segmentet e ndryshme të shoqërisë dhe qeverisë;
- Angazhohen në formulimin e rekomandimeve të politikave për çështjet e përzgjedhura që kanë të bëjnë me demokracinë, qeverisjen dhe fuqizimit ekonomik, të nxjerra nga konsultimet me qytetarët dhe akterët e tjerë;
- Monitorojnë dhe përcjellin zbatimin e legjislacionit të synuar, reformave dhe nismave me rëndësi të madhe për grupet e cenueshme dhe të marginalizuara.

Grantet do të jepen në pesë fusha tematike të detajuara në pjesën e mëposhtme:

- Gratë në qeverisje dhe ekonomi;
- Fuqizimi i grave përmes rritjes së vetëdijesimit rreth të drejtave pronësore të grave;
- Rritja e mbrojtjes dhe e vetëdijesimit për të drejtat e popullsisë së cenueshme;
- Zgjerimi i pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara (PAK); dhe
- Zgjerimi i pjesëmarrjes së të rinjve.

Të gjitha grantet do të administrohen në pajtim me rregulloret e aplikueshme të poshtë shënuara:

- ADS 303
- ADS 303 Kushtet Standarde të Detyrueshme për pranuesit e fondeve nga OJQ-të jo-amerikane
- 48 CFR 31.2 (për organizatat fitimprurëse)

Rregulloret e përmendura më lart mund të shikohen përmes faqes së USAID-it:

<http://www.usaid.gov/business/regulations/>

USAID-i mban të drejtën e financimit të cilitdo aplikacion të dorëzuar apo të mos financoj asnjërin prej tyre.

Për të arritur ndikimin maksimal, ATRC do të vlerësoj kapacitetin e përfituesve të granteve, si dhe të ofroj përkrahje e mbështetje teknike për çështjet në lidhje me projektet e tyre përkatëse dhe menaxhimin organizativ. Përfituesit e granteve, sidomos ata që nuk kanë përvojën e mjaftueshme apo kapacitetet organizative, do të përkrahen përmes ndihmës së vazhdueshme të ATRC-së në implementimin e granteve në kuadër të E4E-së.

*Përfituesit e granteve obligohen të ndajnë resurset e tyre në planin e projektit dhe propozimin e koston sipas Udhëzimeve për Koston e Propozuar. Projektet e aplikuesve për grante duhet të jenë efektive në kosto dhe të demonstrojnë përkushtimin e tyre ndaj suksesit të projektit, duke përfshirë edhe participimin me fonde përkatëse si dhe/ose kontribute në natyrë. Participimi ose kontributi në natyrë është i obligueshëm me 15 %.*

Kjo KPA është nxjerrë për qëllimet e këtij programi, dhe përbëhet nga pjesët vijuese:

- Sesioni I – Përshkrimi i mundësive të financimit;
- Sesioni II – Informata për grantin;
- Sesioni III – Informatat për kualifikim;
- Sesioni IV – Informata për rishikimin e aplikacioneve;
- Sesioni V – Rregulloret dhe referencat;
- Sesioni VI – Informata për dorëzimin e aplikacionit;
- Sesioni VII – Shtojcat.

### **Sesioni I: Përshkrimi i mundësive të financimit**

#### **PRAPAVIJA/HYRJJE:**

Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC), partner implementues i Programit të USAID-it Angazhimi për Barazi (E4E), në përputhje me autorizimet e dhëna në Ligjin e Ndhmës së Jashtme të vitit 1961, të ndryshuar më pastaj, si dhe në pajtim me Marrëveshjen e Bashkëpunimit të USAID-it nr.: AID-167-A-15-00001, kërkon aplikacione nga organizatat e kualifikuara joqeveritare të Kosovës. Ndhma do të jetë në formë të Marrëveshjeve Standarde dhe/ose të Thjeshtuara të Granteve, në pajtim me Kapitullin 303 të Sistemit të Automatizuar të Direktivave të USAID-it (ADS 303 <http://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1868/303.pdf>).

USAID-i ka bërë një marrëveshje bashkëpunimi me ATRC-në, organizatë lokale joqeveritare, për të fuqizuar rolin e shoqërisë civile në rritjen e demokracisë kritike, si dhe çështjeve të qeverisjes dhe ekonomisë, por edhe për të ndikuar në zhvillimin dhe zbatimin e politikave që adresojnë grupet në nevojë dhe të marginalizuara, përmes implementimit të programit “Angazhimi për Barazi”.

ATRC do të shërbej si Organizatë Përkrahëse Ndërmjetësuese (ISO) si dhe pritjet të organizoj, ndaj dhe mbikëqyr implementimin dhe menaxhimin financiar të fondeve në grante të shoqërisë civile, me theks tek fuqizimi i grave përmes përmirësimit të të drejtave pronësore, rritjes së angazhimit të grave në qeverisje e ekonomi: të drejtat dhe pjesëmarrja e komunitetit lesbike, gej, biseksual, transgjinnor dhe interseksual (LGBTI); përfaqësimi i personave me aftësi të kufizuara (PAK), si dhe rinia.

Programi E4E - përmes administrimit të granteve - përpiqet ta përmirësojë integrimin e grupeve të cënueshme dhe të marginalizuara, si çështje e të drejtave të njeriut dhe e zhvillimit të qëndrueshëm. Në veçanti, E4E synon të ndikojë në hartimin dhe zbatimin efektiv të politikave që kanë të bëjnë me popullatën e cënueshme, duke forcuar rolin e shoqërisë civile në promovimin efektiv të çështjeve kritike më të gjëra të demokracisë dhe qeverisjes.

ATRC gjithashtu do të ofroj ndihmë në zhvillimin e kapaciteteve organizative dhe teknike për nën-kontraktuesit, sipas nevojës, për të siguruar zbatim efektiv të programit, si dhe për të përforcuar kapacitetet organizative dhe teknike të nën-kontraktuesit.

Mundësitë për grante do të ofrohen disa herë gjatë zbatimit të këtij programi, ku Rundi I është shpallur në qershor të vitit 2015, kurse ndarja e fundit e granteve do të bëhet në fillim të vitit 2020.

**Përfituesit e granteve përmes Programit E4E duhet të adresojnë një prej fushave tematike të shënuara më poshtë:**

**Tema 1: Gratë në qeverisje dhe ekonomi**

Në kuadër të temës 1, ATRC-ja do t'i mbështesë me grante OSHC-të kosovare që synojnë mundësinë e zhvillimit të aktiviteteve në edukimin publik dhe avokimim, për të ngritur vetëdijen dhe për t'i ndryshuar qëndrimet rreth pjesëmarrjes aktive dhe udhëheqësisë së femrave në ekonomi. Aktivitetet e mbështetura do të promovojnë përmirësimin e politikave në përfaqësimin, punësimin, arsimin dhe pjesëmarrjen e grave në qeverisje dhe ekonomi. Aktivitetet mund të përfshijnë (por të mos kufizohen): (1) Promovimin e zhvillimit profesional; (2) Avokimin dhe komunikimin për mundësi të drejta dhe të barabarta për gratë afariste dhe sipërmarrëse; (3) Dialogun publik dhe forumet e ngjashme që gratë të angazhohen me zyrtarët qeveritarë dhe përfaqësuesit e zgjedhur; dhe (4) Promovimin e të drejtave të grave, pjesëmarrjes dhe udhëheqësisë së grave në proceset formale dhe joformale të parandalimit të konfliktit, përmes aktiviteteve që synojnë identifikimin dhe parandalimin e qëndrimeve ekstreme politike dhe shoqërore që mund të çojnë në ekstremizëm të dhunshëm.

**Rezultatet e parashikuara në kuadër të kësaj teme përfshijnë:**

1. Organizatat që përfaqësojnë interesat e grave bëhen zë i fuqishëm në mbështetje të çështjeve që ndikojnë të gratë;
2. Interesat e grave përfaqësohen më mirë gjatë formulimit dhe zbatimit të politikave publike, duke përfshirë buxhetimin me bazë gjinore, legjislacionin e përmirësuar etj.;
3. Vetëdije më e lartë dhe kontribut në ndryshimin e sjelljes së shoqërisë, përkritazi me rolin dhe rëndësinë e përfshirjes së grave në ekonomi dhe qeverisje;
4. Gratë më aktive në proceset formale dhe joformale të parandalimit të konfliktit që i kontribuojnë qeverisjes dhe ekonomisë së qëndrueshme.

**Tema 2: Fuqizimi i grave përmes rritjes së vetëdijësimit rreth të drejtave pronësore të grave;**

Në kuadër të temës 2, ATRC-ja do t'i mbështesë OShC-të kosovare që të zhvillojnë aktivitete të edukimit publik dhe avokimit për të ngritur vetëdijen dhe për t'i ndryshuar qëndrimet ndaj të drejtave pronësore për gratë në aspektin e pronësisë, trashëgimisë dhe të drejtës së shfrytëzimit. Aktivitetet e mbështetura përmes granteve mund të përfshijnë (por të mos kufizohen): (1) Fushata publike vetëdijësuese që kanë të bëjnë me Strategjinë Kombëtare për të Drejtat Pronësore në nivel qendror dhe lokal, me fokus të veçantë të rinia; (2) Monitorimin e zbatimit të strategjisë kombëtare për të drejtat pronësore në nivel lokal dhe kombëtar; (3) Monitorimin e gjykatave nga OShC-të në lëndët pronësoro-juridike të trashëgimisë; dhe (4) Rritjen e vetëdijes për grupet e grave ndërmarrëse për të drejtën e përdorimit të pronës si kolateral.

Aktivitetet në kuadër të këtij komponenti do ta përplotësojnë punën e Programit të USAID-it për të Drejtat Pronësore (PRP), tema 3: Avancimi i të drejtave të grave për ta përdorur pronën në praktikë.

**Rezultatet e parashikuara në kuadër të kësaj teme përfshijnë:**

1. Vetëdije të shtuar për çështjet e të drejtave pronësore të grave në mesin e popullatës së përgjithshme, duke përfshirë rininë;
2. Vetëdije të shtuar për Strategjinë Kombëtare për të Drejtat Pronësore (SKDP-në) në publik;
3. Monitorim të përmirësuar të zbatimit të SKPD-së;
4. Fuqizimin e grave për t'i kërkuar interesat pronësore të tyre; dhe
5. Miratimin, ndryshimin dhe zbatimin e ligjeve dhe politikave për mbrojtjen e të drejtave pronësore të grave që i inkorporojnë rekomandimet e OShC-ve.

**Tema 3: Rritja e mbrotjes dhe e vetëdijes për të drejtat e popullsisë së cenueshme.<sup>1</sup>**

Në kuadër të temës 3, ATRC-ja do t'i mbështesë organizatat e shoqërisë civile të cilat adresojnë dhe marrin iniciativa për rritjen e vetëdijes, ndryshimin e qëndrimeve, përmirësimin e kornizës ligjore për zbatim më të mirë të ligjeve në mbrojtje të grupeve të cenueshme. Aktivitetet e mbështetura, ndër të tjera do t'i kontribuojnë qasjes së përmirësuar në drejtësi për të gjithë, përmes bashkëpunimit për forcimin e institucioneve, akterëve dhe proceseve që ofrojnë ndihmë, shërbime dhe informacione juridike. Aktivitetet gjithashtu do të ndihmojnë në fuqizimin e grupeve të cenueshme dhe promovimin e bashkëpunimit më të lartë midis segmenteve të ndryshme të shoqërisë civile për ta mbrojtur popullatën e cenueshme nga diskriminimi dhe shkeljet e të drejtave të njeriut. Aktivitetet e mbështetura përmes granteve mund të përfshijnë (por të mos kufizohen): (1) Fushata për të drejtat e njeriut dhe kundër diskriminimit; (2) Monitorimin e zbatimit të legjislacionit përkatës në nivel lokal dhe kombëtar, për të siguruar respektimin e të drejtave të popullsisë së cenueshme; (3) Mbështetjen për përmirësimin dhe zbatimin e kornizës ligjore të Kosovës, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, e cila e trajton diskriminimin dhe shkeljet e të drejtave të njeriut, qasje e shtuar e qytetarëve në informata që kanë të bëjnë me të drejta ligjore, ofrim të shërbimeve ligjore, dhe/apo përmirësim të njohurive ligjore dhe fuqizimin e popullsisë së cenueshme.

Aktivitetet në kuadër të këtij komponenti do ta përplotësojnë edhe punën dhe veprimtarinë e Programit të USAID-it Drejtësia është me Rëndësi (Justice Matters).

**Rezultatet e parashikuara në kuadër të kësaj teme përfshijnë:**

1. Vetëdije dhe ndjeshmëri të shtuar ndaj çështjeve të grupeve të cenueshme dhe të të drejtave të njeriut në mesin e popullatës së përgjithshme;
2. Raportim të përmirësuar të shoqërisë civile për rastet e diskriminimit tek autoritetet e Qeverisë së Kosovës dhe numrin e shtuar të rasteve të diskriminimit të shqyrtuara në gjykata, për shembull duke i përdorur procedurat civile strategjike;
3. Qasje e shtuar e qytetarëve në informata, njohuri të shtuara ligjore, fuqizim i popullsisë së cenueshme dhe qasje në shërbime ligjore; dhe
4. Përfaqësim i shtuar i grupeve të cenueshme nga ofruesit e ndihmës juridike *pro bono* në rastet e të drejtave të njeriut, përfshirë çështjet pronësoro-juridike/të trashëgimisë.

---

<sup>1</sup>Të pafavorizuar dhe të marginalizuar për shkak të përkatësisë gjinore, përkatësisë etnike (për shembull, por jo përjashtimisht, komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian), moshës, paaftësisë fizike dhe mendore, statusit socio-ekonomik ose orientimit seksual e identitetit gjinor.

#### **Tema 4: Zgjerimi i pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara (PAK);**

Nën temën 4, ATRC-ja do t'i mbështesë organizatat e shoqërisë civile të cilat adresojnë promovimin e reformës së politikave, përfaqësimit, punësimit, edukimit dhe pjesëmarrjes së Personave me Aftësi të Kufizuar (PAK). Aktivitetet e mbështetura përmes granteve mund të përfshijnë (por të mos kufizohen): (1) Lehtësim dhe rritje e pjesëmarrjes së PAK-ve në aktivitetet qytetare; (2) Avokim dhe vetëdijësimin nga OSHC-të për planifikimin urban dhe objektet publike; (3) Fushata vetëdijësuese për destigmatizimin e PAK-ve përmes mediave elektronike/të shtypit, medias (televizionit) dhe rrjeteve sociale; (4) Avokimin dhe promovimin e mundësive të biznesit dhe ndërmarrjeve sociale për trajnimin/përfshirjen e PAK-ve; (5) Monitorim të zbatimit të ligjeve që kanë të bëjnë me PAK-të.

#### **Rezultatet e parashikuara në kuadër të kësaj teme përfshijnë:**

1. Vetëdije të shtuar për të drejtat e PAK-ve në shoqëri dhe mbrojtjen e tyre;
2. Përfshirje e shtuar të PAK-ve në angazhim qytetar, punësim dhe mundësi për shkollim;
3. Qasje e shtuar të PAK-ve në objektet publike;
4. Zbatim i shtuar i Ligjit për Personat me Aftësi të Kufizuara;
5. Dialog më konstruktiv midis shoqërisë civile dhe institucioneve qeveritare për nevojat e PAK-ve.

#### **Tema 5: Zgjerimi i pjesëmarrjes së të rinjve**

Në kuadër të temës 5, ATRC-ja do të mbështesë nisma të lansuara nga grupet që përfaqësojnë interesat e të rinjve. Aktivitetet parashohin promovimin e politikave, përfaqësimin, punësimin, edukimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në një varg çështjesh civile dhe ekonomike. Aktivitetet duhet t'i trajtojnë nevojat e popullatës së gjerë, të të rinjve të papunë në Kosovë, të cilëve u mungon edhe motivimi, e edhe mundësitë për angazhim politik dhe angazhim në komunitet. Organizatat e shoqërisë civile do ta mbështesin dialogun dhe bashkëpunimin për krijimin e tolerancës për ta stimuluar dialogun dhe debatin pozitiv, ndërsa luajnë një rol kyç në rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në promovimin e reformës së politikave, përfaqësimit, punësimit, edukimit dhe pjesëmarrjes së të rinjve në një varg çështjesh civile dhe ekonomike. Në të njëjtën kohë, aktivitetet do t'i trajtojnë problemet e shkaktuara nga mungesa e mundësive, mungesa e profesionit dhe thjesht koha e lirë e tepërt, për të krijuar alternativa jo të dhunshme që do t'i plotësojnë këto nevoja në mesin e të rinjve më të rrezikuar. Aktivitetet e mbështetura përmes granteve mund të përfshijnë (por të mos kufizohen): (1) Fuqizimin e të rinjve të rrezikuar në komunat e synuara përmes aktiviteteve që ofrojnë alternativa pozitive për të rinjtë, me qëllim të tërheqjes së individëve të marginalizuar të cilët përndryshe mund t'i kthehen ekstremizmit të dhunshëm; (2) Mbështetjen e dialogut dhe bashkëpunimit për ndërtimin e tolerancës që stimulon dialogun dhe debatin pozitiv; (3) Monitorimin e zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit të Qeverisë së Kosovës për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm (PEDh-së); (4) Shqyrtimin se si "faktorët shtytës"<sup>2</sup> siç është marginalizimi social, sundimi i dobët i ligjit, papunësia dhe

---

<sup>2</sup>Dhuna ekstremiste paraqet kërcënim serioz për vlerat dhe shoqëritë demokratike në mbarë botën. Faktorët "shtytës" strukturorë krijojnë kushte që nxisin ngritjen ose përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm (EDh-së). Faktorët "shtytës" janë socio-ekonomikë, politikë dhe kulturorë për nga natyra. Faktorët e tillë përfshijnë: shkallën e lartë të marginalizimit dhe fragmentarizimit shoqëror, fushat e qeverisura keq apo të paqeverisura, represionin qeveritar dhe shkeljet e të drejtave të njeriut, perceptimet e kërcënimeve kulturore, korrupsionin endemik dhe mosndëshkimin e elitës.

korupsioni po trajtohen nga Qeveria e Kosovës për të përcaktuar nëse ka lëvizje drejt përmirësimit të shkaqeve themelore.

**Rezultatet e parashikuara në kuadër të kësaj teme përfshijnë:**

1. Përfaqësim më të mirë të interesave të të rinjve gjatë formulimit dhe zbatimit të politikave publike;
2. Alternativa pozitive të shtuara për të rinjtë;
3. Krijim i hapësirave të shtuara për dialog produktiv dhe konstruktiv midis rinisë dhe institucioneve qeveritare;
4. Angazhim i shtuar i të rinjve në monitorimin e politikave publike dhe zbatimin e reformave dhe ligjeve që trajtojnë ekstremizmin e dhunshëm;
5. Gjetje dhe rekomandime të realizueshme për përmirësimin e zbatimit të strategjisë së Qeverisë së Kosovës për PEDh-në dhe prezantimin e planit të veprimit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm të paraqitur tek agjencitë relevante.

**Shënim:**

**Grantet e mëdha:** Nga 50,000 deri në 100,000 dollarë për grant. Këto grante janë paracaktuar për përfitues që adresojnë objektivat programore ambicioze për të plotësuar qëllimet tjera strategjike të zyrës së USAID në Kosovë. Për shembull, USAID Kosovë kërkon aktivitete plotësuese për programin Drejtësia është me Rëndësi (Justice Matters), i cili në komponentën e tretë ka për qëllim realizimin e avokimit kompleks dhe fushatës për ngritje të vetëdijes në nivelin kombëtar, duke përfshirë një gamë të gjerë të akterëve nga segmente të ndryshme të shoqërisë dhe qeverisë.

**Grantet e mesme:** Nga 25,000 deri në 50,000 dollarë për grant. Këto grante janë paracaktuar për programet me objektiva programore ambicioze që kërkojnë përcjellje afatgjate dhe zbatim në nivel kombëtar ose rajonal.

**Grantet e vogla:** Nga 10,000 deri në 25,000 dollarë për grant. Projektet në kuadër të granteve të vogla mund të zbatohen në nivel kombëtar, rajonal ose lokal.

**Ndihma e synuar teknike dhe zhvillimi organizativ** do të ofrohet nga ATRC. ATRC do të identifikojë prioritetet e zhvillimit të kapaciteteve për secilin fitues të grantit, si dhe të hartojë planet individuale të zhvillimit të kapaciteteve. ATRC do të bëjë vlerësimin e brendshëm të fituesve të granteve. Vlerësimi do të bëhet bashkë me fituesit e granteve, duke adresuar edhe nevojat e menjëhershme të kapaciteteve për kryerje të suksesshme të programit, por edhe nevojat afatgjate të ndërlidhura me qëndrueshmërinë e tyre.

**Sesioni II: Informata për grantin**

1. USAID/ATRC, përmes programit E4E ka për qëllim të financojë grante të shumta si përgjigje ndaj kësaj KPA. Kostot e lejueshme duhet të jenë në përputhje me politikat dhe procedurat e

USAID-it si dhe të jenë të arsyeshme, të lejueshme, të ndashme, të dokumentuara dhe të arsyetuara për projektin dhe buxhetin e propozuar.

Si përgjigje ndaj kësaj KPA-je, Programi E4E parasheh të ndaj një numër të granteve të vogla (midis 10,000 deri në 25,000 dollarë për grant), granteve të mesme (midis 25,000 dhe 50,000 dollarë për grant) dhe granteve të mëdha (midis 50,000 dhe 100,000 dollarë për grant).

*Buxhetet e propozuara do të negociohen në bazë të shtrirjes së Programit të propozuar nga pranuesi i grantit.*

*Një organizatë mund të aplikojë në një ose më shumë fusha tematike, por programi E4E nuk jep më shumë se një grant për organizatë.*

2. Aplikacionet e suksesshme do të kenë jetëgjatësi të ndryshme të projekteve, por duhet të përfundojnë në Gusht të vitit 2020.

3. Të gjitha aplikacionet për grante që pranohen brenda afatit do të kontrollohen teknikisht nga personeli i programit E4E.

4. Pas kontrollimit të parë teknik, aplikacionet për grant do të shqyrtohen nga Grupi Këshillues Teknik (TAG), që përbëhet nga anëtarë të jashtëm (që nuk i përkasin ATRC - së). TAG do të shqyrtoj aplikacionet për grante brenda tri javësh nga afati i dorëzimit sipas kriterëve të vlerësimit të përcaktuar me këtë KPA.

5. Aplikacionet e dorëzuara pas datës dhe mbylljes së afatit nuk do të merren parasysh në procesin e shqyrtimit. Edhe kopjet elektronike edhe ato në letër duhen pranuar para datës dhe kohës së mbylljes për t'u shqyrtuar.

6. Pas dorëzimit të Aplikacionit të plotë, personeli i programit E4E do t'i dërgoj Aplikantit një njoftim me email për konfirmim të pranimit të Aplikacionit. Aplikantët që marrin vlerësimin më të lartë, deri në shpenzim të fondeve në dispozicion, do të lëvizin drejt fazës së paradhënies/negocimit të dhënies së grantit. Pas negocimit të suksesshëm dhe miratimit të aplikacionit nga USAID, ai do të financohet me mjetet në dispozicion.

7. Lloji i marrëveshjes do të jetë: Marrëveshje standarde dhe/ose thjeshtësuar e Grantit, sipas ADS 303 të Rregulloreve të USAID.

8. Programi E4E do të përfshij Planin e Shënjitimit dhe Etiketimit të miratuar nga USAID në të gjitha marrëveshjet e bëra sipas kësaj KPA-je (ADS 302 <http://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1868/320.pdf>).

### **Sesioni III: Informatat për kualifikim**

Grantet i jepen vetëm këtyre llojeve të organizatave: Organizatave jo-amerikane, subjekteve me bazë në Kosovë (subjektet qeveritare janë të përjashtuara), organizatave jofitimprurëse dhe organizatave joqeveritare fitimprurëse. Organizatat që përmbushin kriteret e kualifikimit të definuara si më poshtë mund të dorëzojnë një aplikacion si përgjigje ndaj kësaj KPA-je. Ju lutemi



të vëreni që nëse aplikanti nuk përmbush kriteret e kualifikimit, aplikacioni nuk do të pranohet për shqyrtim dhe do të refuzohet.

## **APLIKANTËT KUALIFIKUAR**

USAID/ ATRC do t'u jap grante organizatave që janë ligjërisht të regjistruara dhe të pranuar sipas ligjeve të Kosovës, si dhe që nuk e kanë të ndaluar të marrin fonde të Qeverisë Amerikane.

Aplikantët obligohen të regjistrohen për numrin e Sistemit Universal të Numërimit (DUNS). Informatat për marrjen e numrit DUNS mund të merren në <https://fedgov.dnb.com/webform>.

Për t'u kualifikuar, aplikanti duhet që:

- Të paraqes dëshmi të regjistrimit të vlefshëm sipas Ligjit të Kosovës për Lirinë e Organizimit në Organizata joqeveritare;
- Të paraqes dëshmi të llogarisë bankare të vlefshme në një bankë në Kosovë;
- Të demonstroj gjendjen e rregullt tek Administrata Tatimore e Kosovës; si dhe
- Të dorëzoj numrin DUNS (nëse nuk e keni numrin, ATRC mund t'ju ndihmoj në regjistrimin e numrit DUNS).

Përveç këtyre, aplikantët për grante duhet të demonstrojnë që:

- Posedojnë kapacitete të shëndosha menaxhuese, teknike e institucionale për të arritur rezultatet e projektit;
- Kanë vullnetin e nënshkrimit të certifikatave të sigurisë në fuqi.

## **APLIKANTËT QË NUK KUALIFIKOHEN**

Organizatave të mëposhtme **nuk** kualifikohen për financim nga grantet e programit E4E:

- Partitë politike, degët e tyre apo të ndërlidhura me to;
- Organizatat që paraqiten në listën SAM dhe Programet pa Prokurim apo në listën e Kombeve të Bashkuara (OKB) 1267;
- Organizatat që promovojnë apo angazhohen në veprimtari të paligjshme apo aktivitete anti-demokratike;
- Organizata me bazë besimi që nuk janë në përputhje me Sistemin e Automatizuar të Direktivave (ADS) 303.3.28, që është në përputhje me Urdhrin Ekzekutiv 13279, Mbrojtja e barabartë për ligjet e Organizatave Komunitare me bazë në Besim; si dhe
- Organizatat publike ndërkombëtare.

### **Sesioni IV: Informatat për shqyrtimin e aplikacioneve**

#### **PROCESI I VLERËSIMIT TË PROPOZIMEVE**

Pas datës së mbylljes së KPA-së, ATRC do të bëj kontrollimin fillestar teknik të të gjitha

aplikacioneve. Kontrollimi teknik bazohet në kriteret teknike të përcaktuara me KPA. Për t'u konsideruar si teknikisht të plota, aplikacionet duhet të përmbushin këto kriteret:

- Një kopje origjinale e aplikacionit dorëzohet në zyret e ATRC-së para mbylljes së afatit;
- Versioni elektronik i aplikacionit dorëzohet tek adresa [usaidatrcgrants@advocacy-center.org](mailto:usaidatrcgrants@advocacy-center.org) para mbylljes së afatit;
- Versioni elektronik i aplikacionit ANEKSI A në formatin Word dhe ANEKSI B në formatin Excel.
- Regjistrimi i vlefshëm i organizatës si entitet juridik në Kosovë tek Divizioni i Regjistrimit të OJQ-ve tek Ministria e Administratës Publike të Kosovës (e skanuar);
- Aplikanti ka llogari bankare në njërin prej bankave të Kosovës (përgjigjuni në Aneksin A);
- Është përdorur formulari i duhur për aplikim (ANEKSI A), publikuar për këtë thirrje apo kërkesë;
- Propozimi është shkruar në gjuhën shqipe, serbe ose angleze;
- Propozimi teknik (ANEKSI A) NUK duhet të jetë më i gjatë se 15 faqe;
- Të gjitha fushat e formularit të aplikimit (ANEKSI A) janë plotësuar dhe përdorur saktësisht;
- Mbulesa gjeografike është në përputhshmëri me përmasën e grantit të kërkuar (lokal/rajonar/kombëtar);
- Është përdorur formulari i duhur buxhetor (ANEKSI B. Për Propozim Kosto) dhe është shprehur në Dollarë Amerikan dhe është bashkëngjitur;
- Narrativi buxhetor është përfshirë në formularin e aplikimit (ANEKSI A) si dhe është përgatitur në bazë të linjave buxhetore;
- Partecipimi dhe/ose kontributi në natyrë i aplikantit është treguar në formularin buxhetor (ANEKSI B. Për Propozim Kosto) si dhe pjesën narrative të buxhetit;
- Numri DUNS (kërkohet vetëm nëse merrni fonde);
- Vërtetimi tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) që dëshmon se organizata është e regjistruar në ATK dhe nuk mban borgjë apo obligime ndaj ATK-së (e skanuar); si dhe
- Pakoja e domosdoshme e certifikatave e nënshkruar në ANEKSI A, sesioni V.

Numri i pikave të dhëna tregon rëndësinë relative të secilit faktor, ndërsa radhitja do të bazohet në kriteret dhe pikët e dhëna (100 është numri maksimal i pikëve të lejueshme).

Të gjitha aplikacionet do të vlerësohen në baza konkurruese në pajtim me kriteret e paraqitura si më poshtë. Këto kriteret janë vendosur për të adresuar qëllimet e veçanta të Programit Angazhimi për Barazi. Numri i pikëve të dhëna tregon rëndësinë relative të çdo faktori. Për ta bërë procesin e vlerësimit sa më të qartë që është e mundur, secili aplikant duhet të demonstroj qartë se si propozimi i tij përmbush kriteret në vijim:

1. Aplikacioni teknik: **40 pikë**

- Shkalla në të cilën projekti i propozuar është logjik, i ndërtuar mirë, teknikisht i qëndrueshëm, reflekton vlerësimin e problemeve të mundshme që mund të përballen, si dhe drejtpërdrejt adreson temat e identifikuara me këtë KPA (10 pikë);
- Shkalla në të cilën projekti i propozuar demonstroi kuptim të mirë të çështjeve që duhen adresuar, paraqet qasjen origjinale apo inovatore, si dhe vë rezultate kuptimplote e realiste që do të arrihen brenda afatit të propozuar (15 pikë);

- Shkalla në të cilën aktivitetet e propozuara demonstrojnë ndikimin afatgjatë dhe qëndrueshmërinë (5 pikë).
  - Shkalla në të cilën projekti i propozuar adreson çështjet gjinore (Adresimi i çështjes gjinore në projekt nënkupton që objektivat dhe rezultatet janë të definuar në mënyrë të tillë që aspiratat, dëshirat dhe nevojat e grave dhe burrave janë vlerësuar në mënyrë të barabartë dhe janë përkrahur përmes aktiviteteve të projektit) (10 pikë). *Ju lutem referojuni Sesionit V, Regulloret dhe Referencat, me titull Politika e USAID rreth Barazisë Gjinore dhe Fuqizimit të Grave.*
2. Kosto e propozuar: **20 pikë**
- Shkalla në të cilën kostoja e propozuar është reale dhe përkon me aktivitetet e projektit (10 pikë).
  - Demonstrimi i nivelit të zotimit për të siguruar fondet plotësuese dhe kontributet në natyrë. Ndarja e propozuar e kostos do të vlerësohet në bazë të nivelit të pjesëmarrjes financiare të identifikuar brenda kapacitetit të aplikantit dhe vlera e shtuar që ka për programin (10 pikë).
3. Kapaciteti organizativ: **40 pikë**
- Shkalla në të cilën aplikanti demonstroi përkushtimin ndaj misionit dhe aftësinë për të realizuar projektin e propozuar ashtu siç është planifikuar, përfshirë sistemet adekuate menaxhuese dhe financiare dhe shkalla e diversitetit në udhëheqje dhe strukturë të stafit (15 pikë).
  - Shkalla në të cilën aplikanti demonstroi aftësi në udhëheqje brenda sektorit të ekspertizës (15 pikë).
  - Shkalla në të cilën aplikanti merr parasysh çështjet e ndjeshme gjinore (Organizata inkurajon integrimin e çështjeve të barazisë gjinore në të gjitha nivelet, mjediset dhe në të gjitha fushat e intervenimit) (10 pikë). *Ju lutem referojuni Seksionit V, Regulloret dhe Referencat, me titull Politika e USAID rreth Barazisë Gjinore dhe Fuqizimit të Grave*

## VEPRIMTARITË E PAKUALIFIKUESHME

Fondet e grantit nuk mund të përdoren për këto aktivitete:

- Aktivitete që janë dyfishim i aktiviteteve të programeve të tjera të përkrahura nga Qeveria Amerikane, të zbatuara nga organizata tjera në Kosovë;<sup>3</sup>
- Aktivitete që nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut ose me qëllimet demokratike të tolerancës e harmonisë racore e etnike;
- Shpenzime për ceremoni, ndeja, festime apo “reprezentacioni”, përveç ato që janë specifikuar në grant (për shembull, ceremonitë e hapjes) për promovimin e dukshmërisë së USAID-it para komuniteteve që USAID përpiqet tu shërbej;
- Programe të sterilizimit të pavullnetshëm;<sup>4</sup>

<sup>3</sup> Në rast se aplikacioni zbulon një dyfishim të tillë, aplikuesi do të këshillohet për programet tjera amerikane apo burimet e mundshme të financimit për aktivitete të tilla.

<sup>4</sup> MSP16.a Kriteret për Programet e Sterilizimit Vullnetar

- Aktivitetet e ndërlidhura me abortin apo studimet bio-mjekësore të ndërlidhura me abortimin;<sup>5</sup> si dhe
- Aktivitete që nuk miratohen nga USAID.

### **INFORMATA TË TJERA**

USAID dhe/ose ATRC rezervojnë të drejtën që të financojnë cilindo ose asnjë nga aplikacionet e pranuar. Përveç kësaj, të gjitha grantet nga kjo mundësi financimi varen nga disponueshmëria e fondeve si dhe nga pranimi i numrit të mjaftueshëm të aplikacioneve meritore.

### **Sesioni V: Rregulloret dhe referencat**

**ADS303: Grantet dhe Marrëveshjet e Bashkëpunimit me Organizata Joqeveritare (12/26/2014)**

<http://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1868/303.pdf>

**ADS303mab: Kushtet Standarde për Organizatat Joqeveritare Jo-Amerikane (12/26/2014)**

<http://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1868/303mab.pdf>

**ADS303maa: Kushtet Standarde për Grantet Fikse Detyruese për Organizatat Joqeveritare (12/26/2014)**

<http://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1868/303mat.pdf>

**ADS303mak: Lista Kontrolluese për Kualifikimin e Subjekteve për Grantet me Shumë Fikse (12/24/2014)**

<http://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1868/303mak.pdf>

**ADS303mav: Vërtetimet, sigurimet, deklaratimet tjera të pranuesit, si dhe Kushtet Standarde të Kërkimit (12/24/2014)**

<http://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1868/303mav.pdf>

**2 CFR 200: Kërkesat uniforme administrative, parimet e kostos, si dhe kriteret e auditimit për grante federale**

<http://www.ecfr.gov/cgi-bin/text-idx?SID=bd7139ce8733a80692c32d23f3dd5839&node=pt2.1.200&rgn=div5>

**Profiti nën ndihmën e USAID-it**

<http://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1868/303sai.pdf>

**Politika për barazi gjinore dhe fuqizim të grave**

[https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1865/GenderEqualityPolicy\\_0.pdf](https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1865/GenderEqualityPolicy_0.pdf)

[https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1870/Gender\\_Equality\\_Female\\_Empowerment\\_Policy\\_Factsheet.pdf](https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1870/Gender_Equality_Female_Empowerment_Policy_Factsheet.pdf)

---

<sup>5</sup> MSP16.b Ndalimi i aktiviteteve të ndërlidhura me abortin

## **Sesioni VI: Informata për dorëzimin e aplikacioneve**

Aplikacionet në përgjigje të kësaj KPA-je duhet të dorëzohen në version elektronik në: [usaidatrcgrants@advocacy-center.org](mailto:usaidatrcgrants@advocacy-center.org)

**Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është e mërkure, 31 tetor 2018, në ora 16:00. Verzionet elektronike dhe kopjet e printuara duhet të dorëzohen para afatit të fundit.**

Aplikacionet që pranohen pas kësaj kohe nuk do të shqyrtohen. Propozimet për projekt mund të dorëzohen në gjuhën shqipe, serbe apo angleze. Formulari i bashkëngjitur i aplikimit duhet të plotësohet plotësisht, ashtu që nuk duhet të tejkaloj 15 faqe të shtypura. Propozimet e shkruara me dorë nuk merren parasysh. Aplikacionet e dërguara me faks nuk pranohen. Aplikacionet e dorëzuara **nuk kthehen**.

Të gjitha aplikacionet duhet të dorëzohen në formatin e kërkuar me të gjitha bashkëngjitjet e nevojshme:

- Aplikacioni i plotë
- Formulari i buxhetit
- Kopja e certifikatës së regjistrimit
- Vërtetimi tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës

**ATRC mban të drejtën të përcaktoj nëse aplikacioni është dorëzuar në mënyrë të rregullt apo jo.**

**Aplikantët do të informohen rreth propozimit të tyre dhe për dhënien e granteve jo më vonë se 18 Janar 2019. Ju lutemi vini re: implementimi i iniciativave për projekte pritet të filloj jo më vonë se 31 janar 2019.**

Dokumentacioni i kërkesës për aplikim (KPA) mund të gjendet në:

- Versioni elektronik i KPA-së mund të shkarkohet nga: [www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org)
- Kopjet në CD mund të merren në ATRC, në adresën Gazmend Zajmi, Nr. 20 Prishtinë, Kosovë.

ATRC do të jep përgjigje e sqarime për aplikantët gjatë zhvillimit të propozimeve: ATRC do të mbaj nëntë (9) Punëtori/Seanca informuese për zhvillimin e propozim-projekteve dhe kërkesave të raportimit në nëntë (9) qytete në tërë Kosovën.

**Punëtoritë/Seancat informuese për KPA do të mbahen në:**

<b>Vendi</b>	<b>Objekti</b>	<b>Data</b>	<b>Koha</b>
Gjilan	Hotel Kristal	08 tetor 2018	10:00-11:30
Graçanicë	Hotel Graçanica	08 tetor 2018	14:00-15:30
Pejë	Hotel Dukagjini	09 tetor 2018	10:00-11:30
Prizren	DokuKino	09 tetor 2018	14:00-15:30
Ferizaj	Restorant Orchide	10 tetor 2018	10:00-11:30

Shtërpcë	Restorant Lipa	10 tetor 2018	14:00-15:30
Mitrovicë Veriore	Qendra e qytetit në veri	11 tetor 2018	10:00-11:30
Mitrovicë	Restorant Va Piano	11 tetor 2018	13:00-14:30
Prishtinë	Hotel Sirius	12 tetor 2018	10:00-11:30

Programi E4E nuk mbulon shpenzimet për pjesëmarrje në Punëtori/Seanca informuese.

KPA përfshin të gjitha informatat e nevojshme për aplikim për grant, megjithatë pyetjet në lidhje me këtë KPA mund të dërgohen:

Vëmendje: Stafi i e E4E

Zyra e ATRC-së: Rruga Gazmend Zajmi, Nr 20, 10 000 Prishtinë, Kosovë.

Numri i zyrës: 038 244 810

E-mail: [usaidatrcgrants@advocacy-center.org](mailto:usaidatrcgrants@advocacy-center.org)

**Afati i fundit për pyetje është deri më 22 tetor 2018, në ora 16:00. Pyetjet dhe përgjigjet do tu shpërndahen të gjithë aplikuesve të interesuar deri më 24 tetor 2018 në ora 16:00.**

### **Sesioni VII: Anekset**

1. Formulari i aplikimit (Aneksi A)
2. Formulari për buxhet (Aneksi B)
3. Udhëzuesi për propozimin e kostos (Aneksi C)